



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-32
30.1.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i zbardhur) me (nr.ynë ark.01-3732/1) datë 29.7.2019, njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit në radio nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë (nr.ynë ark 08-207/1 datë 13.1.2023), Deklarata nga udhëheqësi (menaxheri) i SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë – Ana Arnautovska, me nr.ark 08-207/2 datë 24.1.2023, e noterizuar me UZP nr.104/2023 datë 18.1.2023 dhe Deklaratën nga themeluesi/pronari i vetëm i SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë – Veselka Radinska, me nr.ark.08-207/3 datë 24.1.2023 e noterizuar me UZP nr.158/2023 datë 24.1.2023 dhe Konkluzionin me nr.ark.02-321/4 datë 27.1.2023, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 3-të mbajtur më 27.1.2023 miratoi

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“ dhe në uebfaqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim është përfundimtar.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë, është posedues i lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-84 datë 5.1.2015, me vlefshmëri prej 9 (nëntë) vitesh (nga 5 janar 2015 deri më 4 janar 2024.), për transmetim nëpërmjet transmetuesit tokësor, në nivel lokal në zonën e Komunës së Berovës, me shërbim programor me format të përgjithshëm në radio (argëtues) muzikor-radio folës, në gjuhën maqedonase.

Më datë 12.1.2023 SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë, në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) dorëzoi njoftim për ndërprerje me transmetim të programit në radio me (nr.ark.08-207/1 datë 13.1.2023.), me të cilin njofton Agjencinë se SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë për shkak të problemeve financiare nga 9.9.2022 nuk transmeton program në radio, si dhe se nuk do të transmeton më tej program në radio, ku njoftoi se nga sa u tha më lartë drejtuar Agjencisë do të dorëzohet deklaratë e noterizuar.

Më datë 24.1.2023 në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë, SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë, ka dorëzuar Deklaratë për ndalimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio sipas fuqisë ligjore me nr.ark.08-207/2 datë 24.1.2023 e dorëzuar nga Ana Arnautovska nga Berova, në pozitën e udhëheqësit të radiodifuzerit, i noterizuar me UZP nr.104/2023 datë 18.1.2023, ku deklaroi se SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë për probleme financiare nga data 9.9.2022 ka ndërprerë transmetimin e programit në radio. Të njëjtën ditë, në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail të Agjencisë ka dorëzuar dhe deklaratë për ndalimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio sipas fuqisë ligjore me nr.ark.08-207/3 datë 24.1.2023, e dorëzuar nga Veselka Radinska nga Berova, në pozitën themelues/pronar i vetëm i radiodifuzerit, i noterizuar me UZP nr.158/2023 datë 24.1.2023, e cila deklaroi se SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë nga 9.9.2022 ndaloi transmetimin e programit në radio. Transmetuesi në fjalë nuk ka borxh ndaj Agjencisë.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAV), leja për transmetim në radio ose televizion ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe me deklaratën me shkrim ku poseduesi njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimin e programeve në radio dhe televizion. Për përfundimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio ose televizion në bazë ligjore Këshilli nuk miraton vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse lejes i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi (2)).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMA-së, si dhe deklaratat me shkrim të lartpërmendura nga udhëheqësi dhe themeluesi/pronar i vetëm i televizionit, i noterizuar UZP, me nr.104/2023 datë 18.1.2023 dhe UZP nr.158/2023 datë 24.1.2023, janë plotësuar kushtet ligjore për fshirjen e transmetuesit SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë nga regjistri i transmetuesve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, deklarata nga menazheri i SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë – Ana Arnautovska me nr.ark.08-207/2 datë 24.1.2023, i noterizuar UZP, nr.104/2023 datë 18.1.2023 dhe deklaratën nga themeluesi/pronar i SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë – Veselka Radinska me nr.ark.08-207/3 datë 24.1.2023 i noterizuar UZP, nr.158/2023 datë 24.1.2023, dhe në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele me nr.ark.01-3732/1 datë 29.7.2019 dhe Konkluzionin me nr.ark. 02-321/4 datë 27.1.2023, është marrë vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit .

Dorëzuar tek:

- Sektori për mbështetje informative dhe punë të përgjithshme - Arkivi;
- Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike;
- Sektori për financa dhe logjistikë;
- Personave të emëruar në Agjenci për udhëheqjen e regjistrit PA1;
- Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë;
- Drejtuesit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive SHTR SKAJ RADIO PLUS SHPKNJP Berovë dhe
- Agjencisë për komunikim elektronik të RMV-së.